

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Genesis X Skorpio ngjitet në malin italian me 1,100 kuaj fuqi
ADRESA	https://albeu.com/teknologji/auto/genesis-x-skorpio-ngjitet-ne-malin-italian-me-1100-kuaj-fuqi/1012642/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:57:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:53:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0a2c6726eee84afe092b618bc4e3961d8729728a0a14cb37f663e5fa82036e4e
TEKSTI	eeae2a959353c73565c7b2808790a85c8917f7657d2932e36b52ab4245f3b225
PAMJA	2d11ab2a3aedd984ffdfa2936ec4939bcd7b3fdfa45cc31d22f2ff57d351b86b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	95cbbe11d8d82c3e7c5aafb23c895e02397d3abbbd0105eacacd29bb9d26be69
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/95cbbe11d8d82c3e7c5aafb23c895e02397d3abbbd0105eacacd29bb9d26be69>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Genesis X Skorpion ngjitet në malin italian me 1,100 kuaj fuqi



Genesis ka vënë në provë X Skorpion, një prej automjeteve më ekstreme të krijuara nga marka luksoze koreano-jugore. Modeli fuqizohet nga një motor V8 me 1,100 kuaj fuqi dhe lëviz mbi goma gjigante 40-inçeshe.

Ky automjet nuk ka lidhje me supermakinen dizel Skorpion të Audi-t. X Skorpion është një projekt krejtësisht i veçantë, i ndërtuar si një mjet brutal për terrene të vështira, veçanërisht për kushtet e shkretëtirës.

Genesis e zbuloi automjetin në fillim të vitit, duke paraqitur një makinë që ngjan më shumë me një trophy truck sesa me një SUV luksoz. Një video zyrtarë e publikuar së fundmi tregoi se bëhet fjalë për një automjet real dhe funksional, jo vetëm për një koncept virtual.

Debutimi evropian në drejtim i X Skorpion u zhvillua gjatë Tutto Bene Hillclimb 2026, në Itali, transmeton Telegrafi.

Pas timonit u ul piloti i Genesis Magma Racing, André Lotterer, i cili e drejtoi modelin në një mjedis dukshëm të ndryshëm nga terreni për të cilin ai është zhvilluar fillimisht.

X Skorpion përshkoi Strada Borromea, një rrugë 9 kilometra e gjatë që ngjitet drejt malit Mottarone, pranë liqenit Maggiore.

Ngjitja në mal krijoi mundësinë për të vëzhguar sjelljen e automjetit jashtë shkretëtirës. Fuqia prej 1,100 kuajsh, motori V8 dhe rrotat 40-inçeshe e bënë paraqitjen e tij po aq mbresëlënëse sa pritej.

Struktura e X Skorpion-s mbështetet te një shasi tubulare me kafaz të plotë sigurie. Një pjesë e konsiderueshme e përbërësve të saj rrjedh nga teknologjitë e përdorura në garat e qëndrueshmërisë jashtë rruge.

Për ndërtimin e karrocërisë janë përdorur fibër qelqi, fibër karboni dhe Kevlar, ndërsa sistemi i pezullimit është projektuar për të përballuar goditje dhe ngarkesa jashtëzakonisht të mëdha.

të fundit /



Genesis X Skorpion ngjitet në malin italian me 1,100 kuaj fuqi



Flick synon ta drejtojë Barcelonën në finalen e Champions League n...



Përplasja në Komisionin e Ligjeve, Korreshi i përgjigjet...



OKB-ja në Shkup do ta ndihmojë Ministrinë për Marrëdhënie ndërmje...



KDI i kërkon Gjykatës Kushtetuese masë të përkohshme për...



Man United rikthen në radar Branthwaite pas shtatë golave të pësu...



Arrestohen në Athinë dy grekë që dyshohet se tentuan të vidhnin...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Gjatë kthesave, karrociera anon dukshëm. Ky reagim lidhet me natyrën e automjetit, i cili është ndërtuar për terrene shumë më të vështira sesa një rrugë e zakonshme malore.

Projekti nuk kufizohet vetëm te motori me përmasa të mëdha dhe gomat masive. Genesis ka parashikuar që X Skorpio të mund të riparohet shpejt edhe në zona të largëta, larg serviseve.

Panelet e jashtme mund të zëvendësohen, ndërsa pjesët dhe komponentët e ndryshëm janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të ndërrohen shpejt, pa kërkuar orë të gjata pune në një punishte.

Kjo zgjidhje është veçanërisht e dobishme për një automjet që synon të udhëtojë thellë në shkretëtirë, ku pjesët rezervë mund të ndodhen qindra kilometra larg.

Megjithëse pamja e tij është e ashpër, X Skorpio ruan disa elemente të filozofisë luksoze të Genesis.

Në kabinë janë vendosur ulëse ergonomike, rripa sigurie me katër pika, sistem kontrolli të klimës dhe një ekran rrëshqitës. Ky i fundit mund të zhvendoset nga ana e shoferit te pasagjeri, në varësi të faktit nëse automjeti përdoret vetëm apo me bashkëdrejtues.

Instrumentet kryesore janë integruar drejtpërdrejt në timon, duke i mundësuar shoferit të kontrollojë informacionet e nevojshme pa i hequr sytë nga rruga.

Edhe pse mbetet një koncept teknikisht unik, Genesis ka konfirmuar se synon ta ofrojë X Skorpio për entuziastë të pasur të aventurave jashtë rruge.

Marka kishte njoftuar më herët se kishte marrë disa porosi menjëherë pas prezantimit të automjetit. Prodhimi do të jetë shumë i kufizuar dhe do të fokusohet kryesisht te klientët me pasuri të mëdha në Lindjen e Mesme.

Modelet që do të prodhohen nuk do të homologohen për përdorim në rrugët publike.

X Skorpio nuk përfaqëson përpjekjen e parë të Genesis për të krijuar një automjet ekstrem jashtë rruge. Vitin e kaluar, marka prezantoi X Gran Equator, një koncept i menduar për të konkurruar me modele si Rivian R1S dhe Mercedes G-Class elektrik.

X Gran Equator nuk pritet të prodhohet, megjithëse disa prej elementeve të tij të fuqishme mund të përdoren në modelet e ardhshme të Genesis. /Telegrafi/

Shtuar më 15.09.2026 14:53

Tags: Genesis , Genesis x skorpio



Range Rover ndryshon drejtim: më pak ekrane për një kabinë më të qetë



BMW 3 Series G50 shfaqet pa kamuflazh, zbulohet versioni sportiv M350...



Koncepti elektrik i Volkswagen synon mbi 1,400 kilometra autonomi...



Tesla cakton prezantimin e Roadster-it pas nëntë vitesh pritje



Volkswagen prezanton teknologjinë për ndërrim automatik të korsisë



BMW tërheq 189,130 automjete për shkak të rrezikut të zjarrit në motor



Këto janë automjetet me mundësinë më të madhe për të kaluar 400 mijë...



Genesis Magma GT shfaqet në aksion me zërin e një V8 twin-turbo dhe d...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.